REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 46 Prot.

Rrogozhinë, më 28.09.2026

VENDIM

Nr. 36 , datë 28. 09. 2026

PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJË PËR MUAJIN GUSHT 2026 NGA FONDI I BLLOK – NDIHMËS 6%

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e radhës me datë 28.09.2026 mori në shqyrtim projektvendimin e propozuar nga Zv. Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.3775.Prot datë 18.09.2026 "Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Gusht 2026 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6%", si dhe Relacionin shpjegues për këtë projektvendim me Nr.3775/1.Prot datë 18.09.2026.

Në mbështetje të nenit 54 ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 " Për vetëqeverisjen vendore " , i ndryshuar Ligjit Nr.9355 datë 10.03.2005 "Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore" i ndryshuar, Ligjit nr. 57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" Kreu II pika 13 e VKM-së nr. 955, datë 07.12.2016 "Për përcaktimin e kritereve të proçedurave dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike" Udhëzimit nr. 5, datë 17.02.2017 "Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën deri 6 %" . VKB nr.3, datë 30.01.2025 "Për përcaktimin e kritereve dhe dokumentacionit për përfitimin e ndihmës ekonomike për familjet që nuk janë përfitues nga sistemi i pikëzimit, që do të trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur deri 6 % nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën për vitin 2025". Me propozim të komisionit të ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 370 datë 15.07.2024 "Për verifikimin e familjeve që nuk janë përfituese nga sistemi i pikëzimit" , me propozim të Zëvendëskryetarit të Bashkisë ushtrues i detyës së Kryetarit, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Gusht 2026 nga fondi i bllok - ndihmës 6 %.
   - Në total 7 familje që plotësojnë të gjithë kriteret juridike dhe ekonomike për marrjen e ndihmës ekonomike.
2. Fondi total prej 30 869 (tridhjetëmijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë.
3. Këto familje trajtohen në një listë të veçantë me fondin 6% të bllok Ndihmës -Ekonomike, lista si më poshtë vijon :

CamScanner

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

Njësia Gosë	Shuma që përfitojnë
1- Sadije Dull Mici	2 178 lekë
2- Luman Ibrahim Murati	3 960 lekë
3- Saimir Kujtim Malo	4 792 lekë
4- Altin Kujtim Struga	5 881 lekë

Njësia Rrogozhinë	Shuma që përfitojnë
1- Brunilda Sherbet Sina	3 960 lekë
2- Lindita Alush Kashari	2 178 lekë
3- Lindita Qemal Tosku	7 920 lekë

- Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Mbrojtjes dhe Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës pranë Bashkisë Rrogozhinë.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

KRYETARE E KËSHILLIT
MUKADES GIXHARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA RROGOZHINË

Adresa: Lagja Nr.1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori", e-mail: bashkia.rrogozhine@bashkiarrogozhine.gov.al

CamScanner

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 47 Prot.

Rrogozhinë, më 28.09.2026

VENDIM

Nr. 37 , datë 28.09.2026

PËR MIRATIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE TË SHPENZIMEVE PËR PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM TË BASHKISË RROGOZHINË PËR VITET 2027-2029

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e radhës me datë 09.06.2026 analizoi dhe diskutoi në lidhje me projekt-vendimin e ardhur nga Zëvendëskryetari i Bashkisë, me shkresë Nr.1007.Prot datë 09.03.2026 "Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve për programin buxhetor afatmesëm të Bashkisë Rrogozhinë për vitet 2027-2029", si dhe Relacionin shpjegues për këtë projektvendim me Nr.1007/1.Prot datë 09.03.2026.

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015, datë. 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" , i ndryshuar, të Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, ligjit nr.68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Udhëzimit nr.7, datë 27.02.2026 të Ministrisë së Financave "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2027-2029" me propozim të zëvendëskryetarit të bashkisë ushtrues i detyrës së kryetarit, me 15 (pesëmbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) vota kundër, 0 (zero) vota abstenim, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve për programin buxhetor afatmesëm të Bashkisë Rrogozhinë për vitet 2027-2029 sipas tabelave bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Tavanet përgatitore do të shërbejnë si bazë orientuese për përgatitjen e kërkesave buxhetore nga njësitë shpenzuese të Bashkisë Rrogozhinë.
3. Drejtoritë dhe njësitë shpenzuese të bashkisë janë të detyruara të hartojnë kërkesat buxhetore brenda kufijve të tavaneve të miratuara, duke respektuar prioritetet strategjike dhe detyrimet ligjore.

CamScanner

4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Grupi i Menaxhimit Strategjik pranë Bashkisë Rrogozhinë dhe për përgatitjen e projektit të parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

KRYETARE E KËSHILLIT
MUKADES GIXHARI

CamScanner

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 48 Prot. Rrogozhinë, më 28.09.2026

VENDIM

Nr. 38, datë 28.09.2026

PËR MIRATIMIN E PLAN MASASH "PËR PARANDALIMIN DHE MENAXHIMIN E ZJARREVE MASAT QË DUHET TË MERREN PËR MBROJTJEN E PYJEVE DHE KULLOTAVE BASHKIAKE NGA ZJARRET"

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e radhës me datë 28.09.2026 analizoi dhe diskutoi në lidhje me projekt-vendimin e ardhur nga Zëvendëskryetari i Bashkisë, me shkresë Nr.1425/1.Prot datë 15.04.2026 "Për miratimin e Plan Masash 'Për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve masat që duhet të merren për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave bashkiake nga zjarret", si dhe Relacionin shpjegues për këtë projektvendim me Nr.1425/2.Prot datë 15.04.2026.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të ligjit Nr.139/2015, datë. 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" , i ndryshuar, të Ligjit nr.45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", Ligjit nr.152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", neni 30 "Mbrojtja e fondit pyjor kombëtar", pika 4 a/b/c, pika 5 e ligjit 57/2020 "Për Pyjet", VKM nr.1080 datë 22.12.2010 "Për rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe në kullota, si dhe për krijimin e njësive vullnetare të shuarjes së zjarreve", Për mbrojtjen e pyjeve e kullotave nga zjarri dhe ndjekjen e ecurisë së problemeve për M.N.Z.SH për periudhën Maj - Tetor 2026, me propozim të zëvendëskryetarit të bashkisë ushtrues i detyrës së kryetarit, me 16 (gjashtëmbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) vota kundër, 0 (zero) vota abstenim, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Miratimin e Plan Masash "Për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve masat që duhet të merren për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave bashkiake nga zjarret" sipas lidhjes bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Bashkisë, Njësitë Administrative, Drejtoritë e Bashkisë, Stacioni i PMNZSH-së pranë Bashkisë Rrogozhinë.

Adresa: Lagja Nr.1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori", e-mail: bashkia.rrogozhine@bashkiarrogozhine.gov.al

CamScanner

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar dhe pas Konfirmimit Ligjor nga ana e Prefektit të Qarkut Tiranë.

KRYETARE E KËSHILLIT

MUKADES GIXHARI

Adresa: Lagja Nr.1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori", e-mail: bashkia.rrogozhine@bashkiarrogozhine.gov.al

CamScanner

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 49 Prot.

Rrogozhinë, më 28.09.2026

VENDIM

Nr. 39 , datë 28.09.2026

PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS SË BASHKISË RROGOZHINË

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e radhës me datë 28.09.2026 analizoi dhe diskutoi në lidhje me projekt-vendimin e ardhur nga Zëvendëskryetari i Bashkisë, me shkresë Nr.2268.Prot datë 04.06.2026 "Për miratimin programit të transparencës së Bashkisë Rrogozhinë".

Në mbështetje të nenit 54, nenit 55 pika 2 dhe 6 të ligjit Nr.139/2015, datë. 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" , i ndryshuar, të nenit 4 dhe 7 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e Informimit", i ndryshuar, si dhe të ligjit nr.146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", i ndryshuar, të Urdhërit nr.281, datë 30.12.2025 "Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore", me propozim të zëvendëskryetarit të bashkisë ushtrues i detyrës së kryetarit, me 15 (pesëmbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) vota kundër, 0 (zero) vota abstenim, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Miratimin e Programit të Transparencës së Bashkisë Rrogozhinë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Kryetari i bashkisë në zbatim të pikës 1 të këtij vendimi, merr masat përkatëse për miratimin e akteve të nevojshme për publikimin dhe përditësimin e Programit të Transparencës sipas rastit.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Bashkisë dhe drejtoritë përkatëse pranë Bashkisë Rrogozhinë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar dhe pas Konfirmimit Ligjor nga ana e Prefektit të Qarkut Tiranë.

KRYETARE E KËSHILLIT
MUKADES GIXHARI

Adresa: Lagja Nr.1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori", e-mail: bashkia.rrogozhine@bashkiarrogozhine.gov.al

CamScanner

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 50 Prot.

Rrogozhinë, më 28.09.2026

VENDIM
Nr. 40 , datë 28. 09. 2026

PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE PËR BASHKINË RROGOZHINË SIPAS VKM NR.103 DATË 11.02.2026

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e radhës me datë 28.09.2026 mori në shqyrtim projekt - vendimin e propozuar nga Zv.Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.3030.Prot datë 21.07.2026 "Për përllogaritjen e nivelit të pagave për Bashkinë Rrogozhinë sipas vendimit nr.103 datë 11.02.2026" si dhe Relacionit shpjegues të këtij projektvendimi me Nr.3030/1.Prot datë 21.07.2026.

Në mbështetje nenit 113 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1.1, shkronjës "b" të nenit 54, shkronjës "ç", të nenit 55, pikës 2, të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar; të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar , të ligjit nr.68/2018 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", të nenit 6, shkronja "c", nenit 9 të ligjit nr.35/2023 "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi, Vendimin nr.328, datë 31.05.2023 "Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të titullarëve të emëruar, të nëpunësve civilë dhe të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore" të ndryshuar me Vendimin nr.503 datë 1.8.2024, VKM nr.116, datë 12.03.2026, VKB-së Nr.52 datë 24.12.2025 "Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2026". Me me propozim të zëvendëskryetarit të bashkisë ushtrues i detyrës së kryetarit dhe të gjithë drejtorive të Bashkisë, Me 15 (pesëmbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) kundër dhe 0 (zero) abstenim, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Miratimin e nivelit të pagave për funksionarët, nëpunësit civilë dhe të punonjësve administrativë të njësive të bashkisë Rrogozhinë, në zbatim të VKM nr.103, datë 11.02.2026 sipas tabelës si më poshtë vijon :

CamScanner

TABELA E NIVELIT TË PAGAVE PËR PUNONJËSIT E ADMINISTRATËS SË BASHKISË RROGOZHINË

Nr.	Emërtimi	Kategoria	Klasifikimi sipas Vendimit nr.103 datë 11.02.2026 "Për disa ndryshime në VKM Nr. 328, datë 31.05.2023... "	Paga për pozicion
1	Kryetar Bashkie		I-C	246,000
2	N/Kryetar Bashkie		I-C	189,625
3	Këshilltarë të Kryetarit të Bashkisë		III-2	109,000
4	Sekretar i Këshillit Bashkiak	II	II-2	144,525
5	Administrator Njësia Administrative Sinaballaj		Lidhja nr 8/4	143,500
6	Administrator Njësia Administrative Kryevidh, Lekaj, Gosë		Lidhja nr 8/3	148,625
7	Sekretar i Përgjithshëm	I	Lidhja I/5	174,250
8	Drejtor Drejtorie (Aparati, Ligjzbatues, Shërbimesh)	II	II-2	144,525
9	Përgjegjës Sektori (Aparat/Ligjzbatues)	III	III-2	109,000
10	Përgjegjës Sektori (Shërbimesh)	III	III-2	102,000
11	Përgjegjës Zyrës Gjendjes Civile	III	III-3	102,000
12	Përgjegjës Sektori (Aparati, Ligjzbatues, Shërbimesh)	III	III-3	100,450
13	Specialist (Aparati, ligjzbatues)	IV	IV-3	75,000
14	Specialist (Shërbimesh)	IV	IV-3	65,000
15	Specialist (Aparati, Ligjzbatues)	IV	IV-4	65,000
16	Specialist (Shërbimesh)	IV	IV-4	60,000
17	Specialist i Zyrës së Gjendjes Civile	IV	IV-3	75,000
18	Kryeinspektor i IMTV / Policie Bashkiake (Ligjzbatues)	III	III-2	109,000
19	Inspektor i IMTV / Policie Bashkiake (Ligjzbatues)	IV	IV-3	70,000
20	Polic Bashkiak (Ligjzbatues)	KP lidhja 11		57,000
21	Koordinator i dhunës në familje/ Koordinator Komunitar		IV-3	65,000
22	Kryetar Fshati Njësia Administrative Sinaballaj		~5.8 % paga kryetarit, ligji nr.35/2023 ndryshuar me ligjin nr.93/2024	14, 350
23	Kryetar Fshati Njësia Administrative Kryevidh, Lekaj, Gosë		~6 % paga kryetarit, ligji nr.35/2023 ndryshuar me ligjin nr.93/2024	14,862
24	Administrator i lagjes qyteti Rrogozhinë		10% paga kryetarit,ligji nr.35/2023 ndryshuar me ligjin nr.93/2024	24,600
25	Këshilltarë të Këshillit Bashkiak		Pika 1 neni 51 Ligjit 139/2015	24,600

CamScanner

26	Punonjës Informacioni, Magazinier, Taksambledhës, Punëtor gjelbërim-pastrim, Shofer, Manovrator, Eskavatorist, Kaldaist, Elektriçist, Hidraulik, Teknik Ndërtimi, Punonjës Ujitje dhe Kullimi, Punonjës Kulture, Arti, Çerdhe, Punonjës Shërbimesh, Kultura, Arkëtar Njësi, Topograf Njësi.		Lidhja nr.11	57,000
27	Sanitare, Roje Objekti		Lidhja nr.11	50,000
28	Punëtor Shërbimesh		Lidhja nr.11.	50,000
29	Inspektor i Pyjeve	Pika 9	IV-4	60,000
30	Sekretare, Arkiv, Protokoll Njësi	Pika 5/b	IV-4	60,000
31	Punonjës Sezonal			50,000
32	Agronom	IV	IV-4	60,000

2. Ky vendim ka efekte financiare duke filluar nga data 01.01.2026.

3. Vendimi i Këshillit Bashkiak nr.48 datë 26.09.2024, "Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të bashkisë Rrogozhinë", shfuqizohet.

4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore pranë Bashkisë Rrogozhinë.

5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar dhe pas Konfirmimit Ligjor nga ana e Prefektit të Qarkut Tiranë.

KRYETARE E KËSHILLIT
MUKADES GIXHARI

Adresa: Lagja Nr.1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori", e-mail: bashkia.rrogozhine@bashkiarrogozhine.gov.al

CamScanner

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 51 Prot.

Rrogozhinë, më 28.09.2026

VENDIM

Nr. 41 , datë 28. 09. 2026

PËR DHËNIEN E OPINIONIT MBI PROPOZIMIN PËR PLANIN E RI TARIFOR PËR UJËSJELLËSIN RROGOZHINË SIPAS SHKRESËS SË KËSHILLIT MBIKQYRËS TË SHOQËRISË RAJONALE UK DURRËS SH.A ME NR.3235.PROT DATË 08.06.2026

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e radhës me datë 28.09.2026 mori në shqyrtim projekt-vendimin të propozuar nga Zv.Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.2406.Prot datë 11.06.2026 "Për dhënien e opinionit mbi propozimin për planin e ri tarifor për Ujësjellësin Rrogozhinë sipas shkresës së Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë Rajonale UK Durrës sh.a me Nr.3235.Prot datë 08.06.2026"si dhe Relacionin shpjegues për këtë projektvendim me Nr.2406/1.Prot datë 11.06.2026.

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, mbështetur në shkresën "Kërkesë për mbledhjen e Këshillit Bashkiak" me Nr.3235. Prot datë 08.06.2026 të ardhur nga Këshilli Mbikqyrës i Ujësjellës Kanalizime Sh.a Durrës ku kërkohet në dhënia e opinionit të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë si pronar aksioner në shoqërinë Rajonale UK Durrës sh.a mbi propozimin e një plani të ri tarifor për Bashkinë Rrogozhinë, me propozim të zëvendëskryetarit të bashkisë ushtrues i detyrës së kryetarit, Këshillit Bashkiak ,

V E N D O S I :

1. Dhënien e opinionit me , 0 (zero) Këshilltarë pro, 16 (gjashtëmbëdhjetë) Këshilltarë kundër, 0 (zero) Këshilltarë abstenim, mbi propozimin për planin e ri tarifor për Ujësjellësin e Bashkisë Rrogozhinë sipas shkresës së Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë Rajonale UK Durrës Sh.A me Nr.3235. Prot datë 08.06.2026 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim t'i përcillet sipas kërkesës për dhënie opinioni, Shoqërisë Rajonale UK Durrës Sh.A.
3. Ngarkohet për zbatimin dhe përcjelljen e këtij vendimi Kryetari i Bashkisë dhe drejtoria Juridike pranë bashkisë Rrogozhinë.

CamScanner

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

KRYETARE E KËSHILLIT
MUKADES GIXHARI

CamScanner

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 52 Prot.

Rrogozhinë, më 28.09.2026

VENDIM

Nr. 42 , datë 28.09.2026

PËR SUBVENCIONIMIN E QIRASË PËR STREHIMIN E PËRKOHSHËM TË FAMILJEVE, BANESAT E TË CILAVE JANË TË RREZIKUARA NGA RRËSHQITJA E TOKËS NË FSHATIN STERBEG, NJËSIA ADMINISTRATIVE KRYEVIDH, BASHKIA RROGOZHINË

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e radhës me datë 28.09.2026 analizoi dhe diskutoi në lidhje me projekt-vendimin e ardhur nga Zëvendëskryetari i Bashkisë, me shkresë Nr.3669.Prot datë 11.09.2026 "Për subvencionimin e qirasë për strehimin e përkohshëm të familjeve, banesat e të cilave janë të rrezikuara nga rrëshqitja e tokës në fshatin Stërbeg, Njësia Administrative Kryevidh Bashkia Rrogozhinë".

Në mbështetje të, Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit Nr.139/2015, datë. 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" , i ndryshuar, veçanërisht nenit 54, për kompetencat e Këshillit Bashkiak dhe dispozitave për funksionet e njësisë së vetëqeverisjes vendore, ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", i ndryshuar, veçanërisht dispozitave që përcaktojnë përgjegjësitë e njësive të vetëqeverisjes vendore për mbrojtjen civile dhe përballimin e pasojave të fatkeqësive, ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social", i ndryshuar, veçanërisht nenit 31, lidhur me subvencionimin e qirasë në rastet e emergjencës për strehim; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; dokumentacionit teknik dhe administrativ të me administruar nga Bashkia Rrogozhinë, me propozim të zëvendëskryetarit të bashkisë ushtrues i detyrës së kryetarit, me 16 (gjashtëmbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) vota kundër, 0 (zero) vota abstenim, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Të miratojë subvencionimin e qirasë për strehimin e përkohshëm të familjeve banesat e të cilave janë vlerësuar si të rrezikuara nga rrëshqitja e tokës në fshatin Stërbeg, Bashkia Rrogozhinë.

CamScanner

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

2. Të miratojë listën e familjeve përfituese, si më poshtë:

Nr.	Emri , Mbiemri	Vendbanimi	Qira mujore	Periudha	Vlera totale
1	Osman Peza	Stërbeg	13,800 lekë	12 muaj	165,600 lekë
2	Faslli Qoshja	Stërbeg	13,800 lekë	12 muaj	165.600 lekë
3	Shkëlzen Peza	Stërbeg	13,800 lekë	12 muaj	165.600 lekë
	TOTAL		41,400 lekë/muaj	12 muaj	496.800 lekë

3. Masa e subvencionimit të qirasë përcaktohet në shumën 13,800 (trembëdhjetëmijë e tetëqind) lekë në muaj për çdo familje përfituese, për një periudhë prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh.
4. Vlera totale e subvencionimit për tre familjet përfituese për 12 muaj është 496,800 (katërqind e nëntëdhjetë e gjashtëmijë e tetëqind) lekë.
5. Subvencionimi i qirasë do të kryhet në bazë të dokumentacionit justifikues, përfshirë kontratën e qirasë dhe dokumentet e tjera të kërkuara nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë, si dhe në përputhje me rregullat e zbatimit të buxhetit.
6. Përfitimi i përcaktuar në këtë vendim ka karakter të përkohshëm dhe lidhet me nevojën për strehim të sigurt të familjeve për shkak të rrezikut të evidentuar në banesat e tyre.
7. Ngarkohet struktura përgjegjëse për mbrojtjen civile, në bashkëpunim me strukturat sociale dhe administrative të Bashkisë, për verifikimin dhe ndjekjen e vazhdueshme të situatës së familjeve përfituese.
8. Ngarkohet Drejtoria e Financës për planifikimin, angazhimin dhe realizimin e pagesave, në përputhje me fondet e miratuara në buxhet dhe legjislacionin në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin.
9. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë për zbatimin e këtij vendimi.
10. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga ana e Prefektit të Qarkut Tiranë.

KRYETARE E KËSHILLIT
MUKADES GIXHARI

Adresa: Lagja Nr.1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori", e-mail: bashkia.rrogozhine@bashkiarrogozhine.gov.al

CamScanner